



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

THIRRJE PËR APLIKIM

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, bazuar në nenin 19, pika 2/c dhe në nenin 50, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, fton ekspertë nga fusha e kërkimit dhe studimit në industrinë audiovizive, për të realizuar punimin shkencor mbi krizën e televizionit në epokën e mediave digjitale – modeli i përgjithshëm dhe modeli shqiptar.

TERMAT E REFERENCËS

Qëllimi

Punimi shkencor duhet të jetë një kërkim i thelluar dhe i plotë mbi dinamikën dhe performancën në industrinë audiovizive në vendin tonë, shoqëruar me analiza të aspekteve kryesore, si dhe dukuri e prirje bashkëkohore, përfshirë dhe efektet nga procesi i digjitalizimit. Fokusi i punimit të jetë një ndërthurje krahasuese mes dukurive aktuale të tregut shqiptar me tipare të industrisë audiovizive në vende të tjera.

Detyrat

1. Eksperti/ekspertët e angazhuar do të punojnë në mënyrë të pavarur, për të realizuar detyrat e mëposhtme:
2. Monitorim dhe kërkim i thelluar i performancës së tregut audioviziv, sondim i ekipeve redaksionale dhe menaxheriale, analizë e fokusuar dhe krahasuese e dukurive e prirjeve, si dhe prezantim të gjetjeve dhe fenomeneve kryesore.
3. Përmbajtja e të gjithë punimit shkencor, duhet të dorëzohet në AMA si produkt final, në format të faqosur, për të gjithë pjesën me tekst, grafikë, fotografi apo pasqyrimë të tjera të treguesve, duke u konsideruar si material i gatshëm për t’u printuar në formën e një botimi. (AMA në procesin e botimit të punimit ruan të pandryshuar të gjithë linjën editoriale në përmbajtje dhe në formë, sipas kopjes finale që dorëzon eksperti/ekspertët).
4. Eksperti/ekspertët kur angazhohen në takime e prezantime publike, apo dalje të ndryshme mediatike, ku në fokus është ky punim shkencor, përmendin edhe mbështetjen e AMA-s.

Periudha e zbatimit të detyrave

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga dita e nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët dhe perioda e zbatimit të kontratës do të jetë nga 7 deri 10 muaj, sipas dakordësimit mes tyre.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm

1. Të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor i Shkencave” në fushën e mediave dhe komunikimit.
2. Të ketë eksperiencë pune, në fushën e mësimdhënies në universitet, në procesin e kërkimit dhe studimit shkencor mbi mediat dhe komunikimin të paktën për 10 vite.
3. Të jetë shtetas/e shqiptar.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. CV e zgjeruar e angazhimit në fushën e mësimdhënies në universitet, në procesin e kërkimit dhe studimit shkencor mbi mediat dhe komunikimin.
2. Kopje të dokumentacionit mbi gradat dhe titujt shkencorë.
3. Kopje ID/Pasaportë.
4. Vertetim nga institucioni ku punon (duhet të jetë origjinal dhe i lëshuar në muajin janar 2021).
5. Sillabus të punimit shkencor (një përmbledhje 2-3 faqe A4), mbi çështjet dhe nënçështjet kryesore që do të përfshihen në trajtimin e problematikave mbi krizën e televizionit në epokën e mediave digjitale – modeli i përgjithshëm dhe modeli shqiptar.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët mund të paraqiten me propozim për angazhim individual ose me propozim ku përfshihen dy a më shumë ekspertë.

Vlerësimi i ekspertit/ekspertëve do të bëhet mbi bazën përbërjes së dosjes së propozimit që paraqesin në AMA. Konkretisht:

1. CV-së së zgjeruar të angazhimit në fushën e mësimdhënies në universitet, në procesin e kërkimit dhe studimit shkencor mbi mediat dhe komunikimin – **maksimumi 30 pikë**.
2. Kopjet e dokumentacionit mbi gradat dhe titujt shkencorë – **maksimumi 30 pikë**
3. Sillabus të punimit shkencor (një përmbledhje 2-3 faqe A4), mbi çështjet dhe nënçështjet kryesore që do të përfshihen – **maksimumi 40 pikë**

Propozimi duhet të ketë në procesin e vlerësimit **minimumi 70 pikë**.

Propozimi që ka më shumë pikë është fitues i kësaj Thirrjeje.

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda afatit që parashikon kjo Thirrje, pranë zyrës së Arkiv – Protokollit, të AMA-s,

Adresa: AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Rruga “Papa Gjon Pali II”, 1015 Tiranë

APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 22 Janar 2021 ora 12.00.

Tiranë, 8 Janar 2021